



Issue: April 2017



† Message from Father Kostandin

KRISHTI U NGJALL!

VERTET U NGJALL!

Kjo eshte thirrja gazmore te cilen te gjithë ne se bashku do te themi e do te kendojme naten e Ngjalljes se Zotit tone Jisu Krisht, Nje himn gezimi, shprese dhe hareje qe do te mbuloje buzet tona, fytyrat tona dhe zemrat tona. Ne ate cast korrit tone i bashkohen himnet e korreve te zerave te mijra vellezerve e motrave tona anembane rruzullit tokesor, e ate cast kembanat lajmerojne se Shpetimtari i botes i theu portat e hadit, e cliroi njeriun nga skllaveria e djallit dhe drita e jetes se paperenduar ndricoi dhe tiumfoi. Dhe prifti kendon-"Eni merni drite prej drites qe nuk perendon dhe lavderojeni Krishtin qe u Ngjall prej se vdekuresh.

Ky eshte lami i mire per shpetimin e botes, ky eshte lajmi i mire i Mbreterise se Perendise , prandaj dhe shkelqimi i festes te jete nje perjetim i gjalle dhe jo siperfaqesor, te jete nje perteritje e trupit dhe e shpirtit te rrenuar nga pesha e mekatit, dhe jo nje shfaqje e shkelqyer pa jete, nje shfaqje artificiale, por ti japim

kesaj feste rendesine e vertete qe kjo feste duhet te kete.

Sepse dhe ne troparin Ngjallesor e kemi kur prifti kendon-"Ashtu do te humbasin mekaret prej faqes se Perendise,dhe te drejtet do te defrejne." Kjo eshte kuptimi i vertete i Pashkes defrimi ne miresine e pergatitur qe perpara koheve, ne miresine e te vertetave te padiskutueshme e te patjetersueshme te Perendise Triadike.

Pashaka e vertete eshte dita e paperenduar e Zotit e cila eshte e pergatitur qe ne fillim te koherave nga Perendia dhe bashkimi i asaj qe eshte Hyjnore dhe njerezores jane nje dhe te patjetersueshme ne personin e Jisu Krishtit te Ngjallur i cili eshte Pashka e vertete.

Prandaj te gjithë ne motra e vellezer le te jemi te paqshem ne kete dite dhe ne te gjitha ditet tona e te perjetojme ate si nje dite te vetme e te shohim njeri tjetrin nen kete shkelqim Ngjallesor sepse vetem keshtu do te mund te jemi pjese perberese e Pashkes se shenjte e te mbajme brenda vetes tone Gezimin e kesaj feste.

Me ngjalljen e tij te shenjte Krishti permbushi cdo gje dhe na fton dhe ne te gjithëve te shpetohemi e te mbajme llambadhet tona te ndezura ashtu sic thuhet ne kanonin ngjallesor "Le ti dalim perpara me llambadhe ne dore Krishtit qe del prej varrit, si nje dhenderi, dhe le te kremtojme me urdherat kremtedashes Pashken shpetimtare te Perendise." Sot ne kete dite kaq te rendesishme per ne te krishteret orthodhokse ne mbare boten dua tju uroj te gjithëve Gezuar Ngjalljen e Zotit me gezim e me shprese te paperenduar te gjithëve juve motra e vellezer.

Dua tju uroj te gjithëve per dashurine, durimin dhe perkushtimin qe tregoni.

Dua sot ne kete nate te shenjte tju uroj te gjithëve qe Zoti Perendi te jete i pranishem tek gjithesecili prej jush ne zemren tuaj e ne shpirtin tuaj e te ndjeni

brenda jush gezimin e shenjte, e nga buzet tuaja te jete si nje kenge e perjtshme urimi i shenjte-Krishti u Ngjall.

Me lejoni qe duke qene se eshte viti im i pare i sherbimit tim ne Kishen e Shenjte te Shen Nikolles te pranoni te gjithë ju me perulesi urimin tim per nje Pashke te Gezuar ne te gjithë familjet e anetareve te komunitetit orthodoks te kishes sone te Shen Nikolles ketu ne Chikago, per te gjithë anetaret e Bordit drejtues te Kishes sone, psalteve, korrit, kishtareve, kujdestareve te kishes, Shkolles Shqipe dhe gjithë mesuesve te shkolles, Grupit Arberia ,Shkolles se te Dieles, te gjithë simpatizanteve dhe dashamiresve, te gjithë atyre qe kane dhuruar dhe ndihmuar ne mbarevajtjen e kishes sone, dhe te gjitha familjeve shqiptare ketu ne Chikago

Falenderim dhe urimi im shkon tek te gjithë ju per nje Pashke te gezuar dhe plot mbaresi, shendet dhe Bekimet e Zotit qofshin mbi ju te gjithë.

Krishti u Ngjall

*Me dashuri e perulesi Juaji,
At Kostandin Tuda*

"Christ is Risen!"

"Truly, He is risen!"

We will be hearing this greeting as we all celebrate the life-giving Resurrection of our Lord and Savior Jesus Christ. It is a hymn filled with joy, hope and happiness that resonate in our smiles, hearts and souls. On that moment our voices are joined by the voices of millions around the globe who cheerfully celebrate this glorious day in our belief. Our Savior broke the bondage of sin and freed the humans from slavery from the devil and the light of life shone brightly in victory.

The priest sings: "Come ye and receive light from the unwaning light, and glorify Christ, who arose from the dead", and all the people join him in singing this hymn again and again. It is a celebration of the defeat of death, as neither death itself nor the power of the

grave could hold our Savior captive. And the priest follows with the Resurrection Troparion: "Let God arise, let his enemies be scattered; let those who hate him flee from before his face! As smoke vanishes, so let them vanish; as wax melts before the fire, So the sinners will perish before the face of God; but let the righteous be glad. This is the day which the Lord has made, let us rejoice and be glad in it!"

The true meaning of Easter is set in the beginning of time when God made it possible for the Holly and Heavenly to join Humans represented by our Lord and Savior Jesus Christ. That is why, brothers and sisters, we have to live in peace and with peace on this day, and all the days to come, and respect each other as this is the only way we can fulfill the true meaning and the blessing of Pascha.

With his Holy Resurrection, our Lord and Savior Jesus Christ fulfilled everything for us and invited us all to carry on the light. "It is the day of resurrection! Let us be illumined for the feast! Pascha! The Pascha of the Lord! From death unto life, and from earth unto heaven has Christ our God led us! Singing the song of victory: Christ is risen from the dead! (First Ode of the Easter Canon)

On this very special and important day for all Orthodox Christians in world, I want to take the opportunity to wish you all from the bottom of my heart Happy Easte, filled with joy, hope, health and happiness for you all brothers and sisters. I want to be grateful for all the love, patience, and devotion you all give forth. I wish on this Holy Night that Our God is always with you all in your hearts, your souls, in your lives as a long- lasting holy greeting-"Christ is Risen!"

As this is my first year here with you at Saint Nicholas Albanian Orthodox Church, please accept my best wishes on this Holy Pascha for you all, families and community members of the Orthodox Church, members of our Church Parish Council, Members of our Choir and psallts, everyone that

takes care and maintains our Church, teachers and staff of our Sunday School, Albanian School, dancing group "Arberia" all friends of our church, everyone that has donated and contributed time, effort, services, financial means, and other forms of support to make sure we prosper and fulfill our mission. My gratitude, wishes and blessings are with you all on this Holy Pascha filled with health, prosperity and all the blessings from the God!

Christ is Risen!

With love and respect,
Father Kostandin Tuda



SAVE THE DATE!!!

ST. NICHOLAS ALBANIAN ORTHODOX CHURCH
PALM SUNDAY LUNCHEON

SUNDAY, APRIL 9, 2017
IN THE CHURCH HALL
IMMEDIATELY FOLLOWING LITURGY

COME JOIN US FOR A DELICIOUS
FISH Lunch
AND WONDERFUL FELLOWSHIP
ADULTS \$20.00
CHILDREN \$10.00 (non-fish meal)

**To reserve tickets call 773-889-4282 or
send an email with your name, phone
number and number of tickets to
stnicholaschurch2701@gmail.com
Reserved tickets must be paid for in
advance**

SPONSORED BY THE ST. NICHOLAS LADIES
AUXILIARY
PROCEEDS WILL GO TOWARDS THE CHURCH
KITCHEN REMODEL




2017 Memberships

Please send in or drop off your 2017 dues; dues for current members are \$125 per one person, \$200 for husband and wife. Please note "2017 dues" on your check.

If you are not yet a member but would like to join our parish, please speak to a member of the Parish Council for information. There is no initiation membership fee any more.

Member directory

If you need to update or correct your address or phone number for the next membership directory, please contact our church at **773-889-4282** or stnicholaschurch2701@gmail.com. You can also contact Maria Barbachi if you want to give us your e-mail address to receive communication from our church.



†St. Nicholas Ladies Auxiliary

Ladies of St. Nicholas Albanian Church, we are looking to increase enrollment in the St. Nicholas Ladies Auxiliary. We are comprised of women of diverse ages and backgrounds working together to reach out not only to the parish membership, but to the community through fundraising, charitable donations and volunteerism. We are looking for ideas to make this event bigger and better. Won't you come join us? We meet the first Sunday of each month in the church hall.

Gratë dhe vajzat e Kishës Shqipëtare të Shën Kollit,qellimi jonë është të ritim numrin e pjesëmarrësve në St. Nicholas Ladies Auxiliaries. Ky grup përbëhet nga gra dhe vajza të të gjitha moshave dhe të gjitha profesioneve që punojnë së bashku jo

vetëm per tu lidhur më shumë me anëtarët e kesaj kishe por edhe me tërë komunitetin nëpërmjet evenimenteve për ngritjen e fondeve, nëpërmjet kontributeve dhe ndihmës që i ofrojmë komunitetit. Kërkojmë më shumë ide te reja për ta zgjeruar dhe për ta forcuar këtë grup. Jeni të gjitha të mirëpritura të dielën e parë të cdo muaji!



†NOTICE/NJOFTIME

†Appreciation/ Mirenjohje

Have you noticed the new doors leading to the church hall? This is one of the latest updates done at our church as well as the installment of a new security system. These two projects were initiated and overseen by members of our community who also donated materials and labor to make it happen. Special thanks and appreciation to Abe Asllani for our new doors, as well as Angelo Dimitri and Kenny Kondraro for our church security system. May God Bless them!

Ne rast se keni ardhur ne kishë javet e fundit duhet ti keni vene re dyert e reja qe te drejtojnë ne hollin e kishes. Ky projekt bashke me installimin e sistemit te ri te sigurise te kishes, u ndermorren dhe u mbikqyren nga anetare te komunitetit te kishes sone qe gjithashtu dhuruan materialet dhe punen per keto projekte. Le te falenderojme Abe Asllani per dyert e reja te kishes si dhe Angelo Dimitri bashke me Kenny Kondraro per sistemin e sigurise se kishes. Zoti i bekoftë!

†We Need Your Help/ Kerkohet ndihma tuaj

We are in the process of collecting memorabilia that reflect the history of our church and its community in years. They will be used to create slide shows to be presented in recognition of 30 years anniversary of weeping of Virgin Mary as well as for the celebration of 80th birthday of our very own His Grace, Bishop Ilia. Please send any photos, newspaper clips, videos, or

any other form of memorabilia either by mail at: 2701 N. Narragansett Avenue, Chicago, IL 60639 or our church e-mail address

www.stnicholasalbanianchicago.org. If you have any specific question you can contact Maria Barbachi at 773-889-4282 or at the e-mail address stated above.

Per te kujtuar 30 vjetorin e dites kur qau Shen Maria ne kishen tone si dhe per te festuar ditelindjen e Hiresise se Tij, Bishop Ilia po grumbullojme fotografi, artikuj gazetsh dhe forma te tjera kujtimi qe reflektojnë historine e kishes sone dhe te komunitetit te saj. Ne rast se deshironi te kontriboni per kete projekt, ju lutemi dergoni cdo forme memorabilia qe keni me poste ne adresen e kishes: 2701 N. Narragansett Avenue, Chicago, IL 60639 ose me e-mail ne adresen www.stnicholasalbanianchicago.org. Ne rast se do te doni me shume informacion apo keni pyetje per kete projekt, ju mund te kontaktoni Maria Barbachi ne numrin 773-889-4282 ose ne adresen e e-mail te kishes permendur me lart.

†Icon Return/ Kthimi i ikonave

We want to thank again everyone who participated and all who generously donated at the Bidding of Icons. The due date for the icons to be returned was February 23. Please make sure return any icons to the church at your earliest convenience so we can do a full inventory.

Duam te falenderojme perseri te gjithë ata qe morren pjesë dhe kontribuan perzemersisht ne ankandin e ikonave ne Janar. Dita e fundit per te kethyer Ikonat ishte 23 Shkurt. Ju lutemi ketheni ikonat ne kishë ne rast se i keni akoma sa me shpejt te keni mundesi per aresye iventari.

† Students of our Sunday School have already started their Easter Fundraising project. Again this year they are decorating Easter candles that will be sold at the candle stand of our church during Easter week. Anybody who wants to participate or donate please let Sunday school teachers know.

Studentet e Shkolles te se Dieles kane filluar projektin e tyre te Pashkes me qellim per te ngritur fonde per kishen tone. Ata perseri kete vit po zbukurojne qirinj per Pashken. Keta qirinj do te shiten ne kishë gjate javes se Pashkes. Ne rast se deshironi te ndihmoni apo te kontriboni per kete projekt, ju lutemi kontaktoni mesueset e shkolles te se Dieles.



† Prayer list / Lista e lutjes

Please remember these people in your prayers: *Ju lutemi mos harroni të perfshini edhe këta njerëz në lutjet tuaja:*

Fr. Philip, Gregory, Lillian, Richard, Perry, Olga, Eva, Kay, Annie, Debra, Helen, John, Tina, Linda, Will, Peter, Mary, Rick, Sam, Nick, Cathy, Anastasia, Kathy, Vincenzina, Niki, Vasiliki, Dita, the men and women serving in the military, and those who have no one to pray for them. If you need to request a prayer for yourself or your beloved ones, please contact Mirela Pajcini @ 630-792-1235



St. Nicholas Albanian Orthodox Church

Schedule of Services

April / Prill 2017

DATE	TIME	EVENT / EVENIMENTI	SERVICE
Sun. 4/ 2	10:00 AM	Sunday of St. Mary of Egypt † V KRESHMËS (Maria Egjiptiane)	Divine Liturgy Liturgjia Hyjnore
Sat. 4/ 8	10:00 AM	Lazarus Saturday Shen Llazari	Divine Liturgy Liturgjia Hyjnore
Sun. 4/ 9	10:00 AM	Palm Sunday – Entrance of Christ in Jerusalem E Shtuna e Shpirtrave	Divine Liturgy Liturgjia Hyjnore
	7:00 PM	Bridegroom Matins Sherbesa e Dhendrit	Service Sherbesa
Mon. 4/ 10	10:00 AM	Holy Monday E Hene e Madhe	Presanctified Liturgy Liturgjia

	7:00 PM	Bridegroom Matins <i>Sherbesa e Dhendrit</i>	Service <i>Sherbese</i>
Tue. 4/ 11	10:00 AM	Holy Tuesday <i>E Marta e Madhe e Shenjte</i>	Presanctified Liturgy <i>Liturgjia</i>
	7:00 PM	Bridegroom Matins <i>Sherbesa e Dhendrit</i>	Service <i>Sherbese</i>
Wed. 4/ 12	10:00 AM	Holy Wednesday <i>E Merkura e Madhe</i>	Presanctified Liturgy <i>Liturgjia</i>
	7:00 PM	Holy Unction <i>Efqelia</i>	Service <i>Sherbese</i>
Thur. 4/ 13	10:00 AM	Holy Thursday (Divine Liturgy of St. Basil) <i>E Enjtja e Madhe (Liturgjia Hynore e Shen Vasilit)</i>	Divine Liturgy <i>Liturgjia Hyjnore</i>
	1:00 PM	Holy Communion* <i>Kungimi i shenjte</i>	
	7:00 PM	The Twelve Gospels <i>Leximi I 12 Ungjijve</i>	Service <i>Sherbese</i>
Fri. 4/ 14	8:00 AM	Holy Friday – Royal Hours <i>E Premtja e Madhe – Oret e Medha</i>	Divine Liturgy <i>Liturgjia Hyjnore</i>
	1:00 PM	Un-nailing Vespers - Removal from the Cross <i>Zbritja nga Kryqi</i>	Service <i>Sherbese</i>
	7:00 PM	Lamentations <i>Vajtimet e Epitafise</i>	Service <i>Sherbese</i>
Sat. 4/ 15	10:00 AM	Holy Saturday (Divine Liturgy of St. Basil) <i>E Shtuna e Madhe (Liturgjia Hynore e Shen Vasilit)</i>	Divine Liturgy <i>Liturgjia Hyjnore</i>
	11:00 PM	Ninth Hour – Pannychis <i>Sherbesa e Terenates</i>	Service <i>Sherbese</i>
Sun. 4/ 16	12:00 AM	Resurrection Service <i>Sherbesa e Ngjalljes (Midnight)</i>	Service <i>Sherbese</i>
	12:30 AM	Paschal Service <i>† PASHKA E MADHE, NGJALLJA E ZOTIT TONË JISU KRISHT</i>	Divine Liturgy <i>Liturgjia Hyjnore</i>
	11:00 AM	Agape Vespers <i>Mbrëmësorja e Dashurise</i>	Vesper Service

			<i>Sherbese</i>
<p>Agape Vespers - We invite all parishioners and friends to participate in this special service where you will be hearing the Gospel reading of the day read in many languages. You are also encouraged to bring your children that were unable to attend the evening service. The Gospel reading (John 20:19-25) is recited in many languages which symbolizes that the resurrection of Christ is proclaimed to all the nations of the world. This will be a wonderful experience, especially for the children as they will be given a red egg at the end of service, a symbol of Orthodox Easter and a great blessing. (You can request to have the Gospel reading read in your language by contacting the church office by Saturday, April 8, 2017.)</p> <p>Mbrëmësorja e Dhashurise - Ftojme te gjithë besimtarët te marrin pjesë në këtë shërbesë të vecantë sepse këtë ditë behet leximi i Ungjillit në shumë gjuhë të botes dhe kush deshiron të lexojë ungjillin atë ditë të kontaktojë në kishë për të marrë ungjillin në gjuhën që deshiron, sidomos femijet duhet të jenë të pranishëm për të marrë vezen e kuqe të Pashkes, simbolin e Pashkeve Ortodokse.</p>			
Mon. 4/ 17	10:00 AM	Renewal (Bright) Monday <i>E Hene e Ndrithsme e Ngjalljes</i>	Divine Liturgy <i>Liturgjia Hyjnore</i>
Tue. 4/ 18	10:00 AM	Renewal (Bright) Tuesday <i>E Marta e Ndrithsme e Ngjalljes</i>	Divine Liturgy <i>Liturgjia Hyjnore</i>
Fri. 4/ 21	10:00 AM	Renewal (Bright) Friday / Theotokos of the Life-Giving Spring <i>E Premtja e Ndrithsme e Ngjalljes / Burimi Jetedhenes</i>	Divine Liturgy <i>Liturgjia Hyjnore</i>
Sat. 4/ 22	10:00 AM	Renewal (Bright) Saturday / St. Nathaniel <i>E Shtuna e Ndrithsme e Ngjalljes / Shen Nathanaili</i>	Divine Liturgy <i>Liturgjia Hyjnore</i>
Sun. 4/ 23	10:00 AM	St. Thomas Sunday / Great Martyr St. George <i>E Diela e Thomait / Shen Gjergji</i>	Divine Liturgy <i>Liturgjia Hyjnore</i>
Sun. 4/ 30	10:00 AM	Sunday of the Myrrh Bearing Women <i>E Diela e miroprureseve</i>	Divine Liturgy <i>Liturgjia Hyjnore</i>

